



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Nr. 349 Prot, datë 26.07.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 6381 Prot, datë 26.07.2018

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Midis

MINISTRISË E PUNËVE TË BRENDSHME
AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË

TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

MINISTRISË SË BRENDSHME
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
INSTITUTI I POLICISË SHKENCORE

TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR MBËSHTETJE DHE BASHKËPUNIM

Të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit mes dy institucioneve në përpjekje për rritjen e sigurisë publike;

Me qëllim, intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe forcimin e bashkëpunimit midis institucioneve të zbatimit të ligjit të dy vendeve, nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të përbashkëta;

Me qëllim, vendosjen e bashkëpunimit konkret në fushën e parandalimit dhe zbulimit të ngjarjeve kriminale dhe zbatimin me rigorozitet të legjislacionit, për krijimin e një ambienti më të sigurt për të gjithë qytetarët;

Me dëshirën për të mundësuar arritjen e qëllimeve të sipërpërmendura, nëpërmjet një bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërpolicor, me anë të krijimit të kushteve për zhvillimin shkencor të suksesshëm, midis Agjencisë së Kosovës për Forenzikë (AKF) në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Institutit të Policisë Shkencore (IPSH) në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë;

Në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra nga të dy vendet, si dhe duke respektuar parimet dhe rregullat në fuqi për shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-064 “Për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë”, Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar si dhe në “Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim të ndërsjellët në fushën e sigurisë”, nënshkruar në Tiranë më datë 23 mars 2015;

Palët kanë rënë dakord si vijon;

Neni 1 Qëllimi

Memorandumi i Bashkëpunimit ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet AKF- së dhe IPSH-së, për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizmit në zbatimin e shkencave ligjore si dhe për shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave më të mira.

Neni 2 Shkëmbimi i informacionit

Duke u bazuar në këtë Memorandum, Palët do të mund të shkëmbejnë informacione në lidhje me evidencat e bazave të të dhënave të sistemeve AFIS, CODIS, IBIS – ARSENAL etj, si dhe të dhëna të tjera të vlefshme nga praktika e luftimit dhe zbulimit të krimit në përputhje me legjislacionin kombëtar të secilës palë.

Neni 3 Krijimi i përbashkët i ekipeve të ekspertëve

1. Palët mund të bien dakord të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta në fushat akademike me interes të përbashkët, duke u bazuar në parimet e barazisë dhe reciprocitetit ose trajnime, seminare, certifikime dhe ligjërime në fushat të cilat i zhvillojnë dy institucionet e lartpërmendura si p.sh: daktiloskopi, traseologji, ADN, kimi, balistikë, grafike të shkrimit dhe nënshkrimit, ekzaminime kompjuterike, sistemin e menaxhimit të cilësisë, administrimi i provave materiale, si dhe evidencë e mirëmbajtje të sistemeve kompjuterike.

2. Mbi këto fusha, Palët do të bien dakord mbi programet e trajnimeve, duke i hartuar ato sipas nevojave të veta si dhe duke caktuar kohëzgjatjen e tyre.

Neni 4 Transferimi i rasteve për ekspertim

1. Transferimi i rasteve në mes Palëve, mund të bëhet duke u bazuar në këtë memorandum, në ato raste kur njëra nga Palët, nuk ka ekspertizën e duhur, të cilën mund ta ketë pala tjetër.

2. Rastet e transferuara për ekspertim, mënyra, forma dhe mbulimi i shpenzimeve për ekspertimin, do të vendosen nëpërmjet miratimit të ndërsjellë, me shkrim, të Palëve.

3. Përjashtime do të mund të bëhen për ato raste kur do të dërgohen në mënyrë elektronike, për të marr një mendim ose për të verifikuar saktësinë e ekspertimit.

Neni 5

Transferimi i personelit në kohë të caktuar

Transferimi i ekspertëve, për periudha kohore të caktuara, sipas këtij Memorandumi, mund të bëhet për të ndihmuar dy institucionet në raste të jashtëzakonshme apo të veçanta si dhe në funksion të volumit të punës.

Neni 6

Komunikimi

Për zbatimin e këtij Memorandumi, Palët mund të përdorin të gjitha format e komunikimit, ose do të caktojnë nga një përfaqësues të tyre.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit dhe interpretimit të këtij Memorandumi, do të zgjidhen me mirëkuptim nga palët.

Neni 8

Ndryshimet

Memorandumi i Bashkëpunimit mund të ndryshohet nëpërmjet bisedimeve dhe miratimit me shkrim të Palëve.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Memorandumi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga palët dhe është i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë, mund ta denoncojë atë me shkrim në çdo kohë. Memorandumi do të përfundojë gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij denoncimi nga Pala tjetër Kontraktuese.

2. Nënshkruar në TIRANË, më datë 26.07.2018 në dy kopje, në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

**Për Ministrinë e Punëve të Brendshme
të Republikës së Kosovës**



**Për Ministrinë e Brendshme
të Republikës së Shqipërisë**

